

UDHËZIM
Nr. 16, datë 28.12.2020

**PËR PROCEDURËN E PAJISJES ME LEJE PESHKIMI PËR ANIJET QË
ZËVENDËSOJNË ANIJET E MBYTURA TË PESHKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 11, të nenit 30, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Subjekti pronar i një anijeje të mbytur peshkimi ose trashëgimtarët e tij aplikojnë për leje peshkimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në vijim “QKB”, duke zbatuar të njëjtat rregulla që zbatohen në procedurat e aplikimeve fillestare për pajisje me leje peshkimi.

2. Në kërkesën e aplikimit për t’u pajisur me leje, subjekti i peshkimit duhet të përcaktojë që aplikimi bëhet për zëvendësimin e anijes së mbytur duke specifikuar edhe emrin e saj.

3. Me marrjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit për anijen e re zëvendësuese, Komisioni i Lejeve të Peshkimit Detar në ministri, verifikon, gjithashtu, nëse anija e mbytur e peshkimit ka qenë e pajisur me leje të vlefshme peshkimi.

4. Komisioni i Lejeve të Peshkimit Detar i drejtohet Kapitenarisë së Portit për të verifikuar pronësinë e anijes së mbytur dhe për të marrë një vërtetim për mbytjen e kësaj anijeje mbi bazën e ditarit të Kapitenarisë së Portit, së bashku me një fotokopje të fletës së ditarit.

5. Leja e peshkimit lëshohet nga QKB-ja pas shqyrtimit, verifikimit dhe plotësimit të kushteve të parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, nga Komisioni i Lejeve të Peshkimit Detar në ministri.

6. Subjekti pronar i një anijeje të mbytur peshkimi ose trashëgimtarët e tij, kur aplikojnë për t’u pajisur me leje për anijen e re të peshkimit, si zëvendësim i anijes së mbytur, duhet të vërtetojnë se anija zëvendësuese plotëson kushtet e tjera për pajisje me leje peshkimi, sipas legjislacionit në fuqi të lejeve dhe të licencave.

7. Anijes së re të peshkimit, që zëvendëson anijen e mbytur, i vendoset në regjistrë një Numër i Ri Identifikimi (NFR), me qëllim shmangien e mbivendosjes së të dhënave dhe të informacionit (si data e regjistrimit, data e prodhimit, përmasat etj.) me anijen që ajo zëvendëson.

8. Ngarkohet Komisioni i Lejeve të Peshkimit Detar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi**